

VENDIM
Nr. 213, datë 11.3.2020

**PËR CAKTIMIN E INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË
KULTURORE SI NJËSI ZBATUESE, DHE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E
RESTAURIMIT/RINDËRTIMIT TË PASURIVE KULTURORE**

(ndryshuar me vendimin nr. 869, datë 27.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), si njësi zbatuese për rindërtimin/restaurimin e pasurive kulturore në njësitë territoriale të bashkive Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Rrogozhinë e Vorë, dhe përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit/restaurimit të pasurive kulturore, gjithsej, në *vlerën 223 105 319 (dyqind e njëzet e tre milionë e njëqind e pesë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë*, përkatësisht:

a) Vlerën prej 197 500 584 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh pa TVSH, për:

i. hartimin e projekteve të detyruara për restaurimin/rindërtimin e pasurive kulturore, të dëmtuara;

ii. rishikimin e projekteve të hartuara për restaurimin/rikonstruksionin e objekteve pasuri kulturore, të dëmtuara;

iii. realizimin e studimeve të thelluara komplekse, përfshirë studime gjeologjike, rlevime me aparatura bashkëkohore, sisteme monitorimi të strukturave, të objekteve pasuri kulturore, të dëmtuara.

b) Vlerën prej 25 604 735 (njëzet e pesë milionë e gjashtëqind e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për realizimin e veprimtarive arkeologjike (vëzhgim sipërfaqësor, sondazhe arkeologjike dhe monitorim) në zonat e përcaktuara për hartimin e planeve të detyruara vendore.

3. Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara, pas përfundimit të procedurave në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e fondit për rindërtimin dhe trashëgohen në vitin pasardhës.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama